



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK DREJTORIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE TRAJTIMIT AMTP

PROÇESVERBAL MBI HARTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i prokurimit: **“Blerje, ushqim për qentë”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 të ligjit nr. 139 dt. 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, nenet 10, 19, 20 të ligjit nr. 9936 datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, nenit 8, nenit 9, Kreu II “Përgjegjshmëria Menaxheriale” të ligjit Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar, nenit 34, nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”, nenit 12, nenit 76, pika 3 të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2010 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” i ndryshuar Vendimit të Këshillit Bashkiak, nr. 76, datë, 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, programit AC141 “Mbështetje për zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural”, aktiviteti P. AC141. Q5.O1.A1 “Trajtimi i qenve të rrugës”, A.1.1 “Ushqim për qentë”.

I mbajtur sot me datë ____02.2025, proçerverbali në Bashkinë Shkodër nga specialisti, pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve, Prelë CAMAJ, si personi përgjegjës i ngarkuar mbi përgatitjen e specifikimeve teknike për proçedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje, ushqim për qentë”**, në zbatim të Urdhërit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor **nr.154, datë 17.02.2025**, si dhe bazuar në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 2, “Dokumentimi i procesit” pika 2, shkronja a, neni 74, pika 4”, Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Neni 36 “Specifikimet teknike”.

Qëllimi i këtij prokurimi është blerja e një sasive ushqimore për trajtimin e qenve pranë strehëzës së qenve, në varësi të Bashkisë Shkodër.

Specifikimet teknike për objektin: **“Blerje, ushqim për qentë”**, duhet të plotësojnë kriteret sipas përkshimit të mëposhtëm:

I. DOKUMENTACIONI LIGJOR

Operatori ekonomik që do të marrë pjesë në procedurën e për zgjedhjes së ofertave nga operatorët e specializuar për realizimin e objektit të prokurimit: “Blerje ushqimi për qentë” duhet të përmbajë:

- ✓ Ekstrakt të QKR/Vendim Gjykate (në rast se ofruesi është OJF)
- ✓ Të ketë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të tilla, sipas specifikimeve teknike të kërkuara në tre vitet e fundit në zonën e Qarkut Shkodër.
- ✓ Deklaratë e operatorit që siguron realizimin e shërbimeve sipas specifikimeve të kërkuara.

Operatori që merr pjesë në konkurrim përveç dokumentacionit të përgjithshëm duhet të paraqesë:

- ✓ Përshkrim i aktivitetit dhe CV e saj ku të specifikohen eksperiencat e mëparshme që ka realizuar.

II. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përbërësit:

Misër, mish pule i dehidratuar, mish derri dhe viçi, vajra bimorë të shtypur në të ftohtë, yndyre, petë panxhari, maja, klorur natriumi.

Përbërësit analitikë:

proteina rreth 18%, përmbajtja e yndyrës rreth 9%, fibra e papërpunuar rreth 3,3%, drithi i papërpunuar rreth 5,5%, lagështia deri 10%.

Aditivë për kilogram: Përbërja analitike e aditivëve: vitaminë A (retinolacetat) 6000 IU, vitaminë D3 (kolecalciferol) 600 IU, vitaminë E (DL- α -acetat tokoferil) 60 mg, hekur (hekur (II) monohidrat sulfat) 30 mg, mangan (mangan- (II) -oksid) 11 mg, bakër (bakër- (II) -sulfat-pentahidrat) 5.3 mg, zink (sulfat zinku-monohidrat) 53 mg, jod (jodat kalciumi) 0.5mg, selen (seleniti i natriumit) 0.2 mg, antioksidantë dhe ruajtës natyralë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1.Për qen të rritur:

- Proteina rreth : 18 %
- Yndyrna rreth: 9 %
- fibra e papërpunuar rreth 3,3%,
- Lagështia deri: 10 %
- Proteina të jenë me origjinë shtazore.

3.Kërkesa të tjera:

- Ushqimi të jetë në trajtë krokantesh dhe aromë normale;
- Afati i përdorimit mbi 12 muaj nga dita e furnizimit;
- Amballazhimi në thasë 15-20 kg;
- Marketingu në amballazh të jetë i stampuar;
- Data e prodhimit dhe e skadencës e stampuar në amballazh;
- Vendi i dorëzimit të ushqimit: Strehëza e Qenve, Rrencë, Nj.A. Guri i Zi, Shkodër.
- Produkti duhet të shoqërohet me analizat të lëshuara nga institucionet të autorizuara kombëtare,

Specifikoi: